



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05-03

Data:06/01/2020

PODUJEVË

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, nenin 35 paragrafi 1, 4, 5 dhe 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenin 5 pika c të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe nenin 7 pika 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.10/2018 Normativi për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës shpall këtë:

KONKURS

Pozita e punës: Asistentë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore – në shkollat e Komunës së Podujevës (**4 pozita**)

Vendi i punës: Asistent për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta

Paga bazë: 397.01 €

Kohëzgjatja e kontratës: deri më 31.08.2020

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndhmon fëmijët/ nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- Punon me mësimsdhënësit dhe stafin tjetër së zbatimit e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuara të fëmijëve, përgatitë informatat kthyesë për vështirësitë dhe arritjen e fëmijëve;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/ nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike/ personale, mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësuesin/ mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim;
- Promovon bashkëpunim shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Respektin rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve;
- Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale.

Kushtet: Shkolla e mesme dhe Niveli i 5-të (postsekondar) i kualifikimit asistent për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve) në objektin e ri të Komunës, rr. " Nuhi Gashi " Podujevë
- Diploma mbi përgatitjen profesionale, kualifikimi i nivelit të pestë (5) post-sekondar (kopja e vërtetuar);
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës (nëse ka);
- Certifikatën që nuk jeni në hetime (jo më më të vjetër se 6(gjashtë)muaj.
- Certifikata e vendbanimit;

Afati i konkursit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, pra deri më datë 21.01.2020.

Drejtori i DKA-së

Agim Blakçori

